



**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes verbal**

Sot me datë 24.05.2024 ora 14:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit bashkiak.

*Të pranishëm janë:*

Z. Oltion Luli

Z. Edmond Ndou

Z. Gjergj Sokoli

*Mungon:*

Z.Blendi Gjylbegaj

Znj. Irena Shala

Znj.Valjeta Bajraktari

Znj. Violeta Perndrecaj

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes nuk është prezent. Z.Luli, në cilësinë e Kryetarit citon rendin e ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Gjithashtu vendos edhe për datën e mbledhjes. Mbledhja e radhës e Këshillit bashkiak do mbahet me date: 31.05.2024 ora 17:00.

Rendi i ditës do jetë si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: *"Për emërimin e sekretarit të Këshillit bashkiak, Shkodër"*
2. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2024"*.
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2023, të Bashkisë Shkodër"*.
4. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e planit vendor të veprimit për energji dhe klimë 2023-2030"*.
5. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB-në nr.7 datë:31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit" "Banesa sociale me qira" për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë" për vitin 2024"*.
6. Pr/ Vendim: *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*.

7. Pr/ Vendim: "Për miratimin e vjeljes, mbjedhjes, grumbullimit dhe shitjes me procedurë ankandi publik të prodhimeve të dyta pyjore të boçeve të pishës, rrënjëve të shqopës, bimëve mjekësore tanifere dhe eterovajore natyrore (MTE) për vitin 2024".
8. Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për vitit 2023.
9. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Zbardhi Proces verbalin:

**Irma Sulishti**

KRYETAR

**Olion Lëlli**